



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2025

VENDIM

Nr. 653, datë 23.09.2025

PËR

**PËRSËRITJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM TË GJYQTARES
{...} NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...}, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në 01.10.2026.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.10.2025.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR